



# PRIVATËSIA NË GAZETAT E PËRDITSHME

## **Monitorimi i gazetave të përditshme për pasqyrimin e çështjeve të privatësisë**

(Mars 2009)

*Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit European.  
Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësia e vetme e Institutit Shqiptar të Medias  
dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit  
European.*

## Hyrje

Sjellja e medias në aspektin e ndërhyrjes në privatësinë e individëve ka qenë një çështje e vazhdueshme shqetësimi në skenën e medias shqiptare. Ndërsa në disa raste një ndërhyrje e tillë ka qenë e përligjur në termat e interesit publik, shumë shpesh këto ndërhyrje janë të panevojshme. Edhe në rastet e personave publikë, media shpesh bën të njohura hollësi të parëndësishme të jetës personale, të cilat do të kategorizoheshin më tepër si thashetheme sesa si raportime për një çështje të rëndësishme për shoqërinë, në kuadrin e përgjegjshmërisë së personave publikë. Në fakt, vetë përkufizimi i interesit publik nuk ka një përkufizim të prerë. Fakti që debati për këtë temë ose përpjekjet për të përkufizuar këtë nocion zhvillohen vetën në raste të bujshme dhe nuk përbëjnë një ngacmim për profesionalizmin e medias, nuk ndihmon në përmirësimin e situatës. Ajo që është më e rëndësishme, kjo gjendje e përgjithshme, përveçse që ul nivelin etik të gazetarëve shqiptarë, gjithashtu tërheq vëmendjen edhe nga çështje vërtet të rëndësishme dhe me vlera.

Në këtë kontekst, ky monitorim do të analizojë mënyrën se si media pasqyron dy grupe personash: publikë dhe jo-publikë. Ky dallim bëhet në mënyrë që të identifikohen problemet kryesore dhe prirjet e sjelljes mediatike në lidhje me privatësinë dhe përgjegjshmërinë e medias ndaj publikut. Kjo do të shërbejë gjithashtu si një lloj mjete për përgjegjshmërinë e medias dhe si një mënyrë për të identifikuar nëse interesi publik është linja kryesore që përdorin gazetarët shqiptarë kur ndeshen me çështje privatësie në punën e tyre. Megjithatë, duke pasur parasysh delikatesën e kësaj teme dhe nocionin e vështirë për t'u përkufizuar të vetë privatësisë, një diskutim paraprak teorik i prirjeve, parimeve dhe problemeve kryesore të lidhura me median dhe privatësinë do të ishte i dobishëm me qëllim që të kemi një kuptim dhe vlerësim më të mirë të prirjeve të mediave kryesore shqiptare në praktikë.

### **Debati publik për privatësinë dhe median<sup>1</sup>**

#### ***Përkufizimi i privatësisë***

Ideja e mbrojtjes së privatësisë u formulua për herë të parë në Deklaratën e Përgjithshme të Të Drejtave të Njeriut. Sipas nenit 12 të Deklaratës, ekzistojnë tre kategori kërcënimi për privatësinë në botën moderne:

1. Mbikqyrja e qytetarëve nga qeveria apo organizata private sigurie, grumbullimi i të gjitha të dhënave dhe informacionit të mundshëm, përfshirë përdorimin e metodave të paligjshme (përgjime telefonike, mikrofonat dhe kamerat e fshehura, etj.)

---

<sup>1</sup> Temat e diskutuara në lidhje me debatin e vazhdueshëm publik për median dhe privatësinë janë bazuar në një raport për këtë temë në revistën Spiked.

2. Aksesit në të dhëna personale dhe konfidenciale nëpërmjet bazave të të dhënave të krijuara nga organizata të ndryshme, përfshirë këtu llogaritë financiare, taksat, sigurimin, të dhënat penale apo raportet mjekësore.

3. Shkelja e privatësisë nga media nëpërmjet ndërhyrjes fizike në jetën e dikujt apo në sferën e tij private (p.sh. apartament, tualet apo pavijon spitali); shpërndarja e informacionit për jetën intime të dikujt, shpesh e bërë në një mënyrë mizore apo vulgare; botimi i informacionit të manipuluar, i cili përfshin emra dhe fotografi.

Megjithatë, paqartësia e privatësisë si term ligjor është mbresëlënëse kur krahasohet me terma të tjerë ligjorë më të qartë, si prona private. Një përkufizim i “privatësisë” në kohët e sotme mbështetet te nocioni se nuk duhet ndërhyrë në jetën private të njerëzve. Personat që ngrenë akuza gjyqësore kundër medias gjithashtu po përpiqen ta përkufizojnë privatësinë në terma të hapësirës publike, të cilat ata mendojnë se janë private në njëfarë mënyre.

Reagimi ndaj kulturës së tanishme bashkëkohore të rrëfimit e ka ndryshuar kuptimin e fjalës së lirë dhe privatësisë. Mjegullimi i kufirit mes sferave private dhe publike të jetës shprehet edhe në formën e paqartësisë se si duhet rregulluar me ligj apo si duhet kodifikuar në mënyra të tjera fjala e lirë, me qëllim që të mbrohen ndjenjat e personave të cilët përjetojnë një dhunim të privatësisë.

Duke folur në një debat publik rreth privatësisë dhe medias në 2001, Mike Jempson, drejtor i organizatës për etikën e medias The PressWise Trust, theksoi pushtetin e shtypit. “Kur shtypi dhunon privatësinë e njerëzve të zakonshëm dhe gabohet, kjo gjë ka pasoja të jashtëzakonshme,” tha ai. “Është e qartë se ne duhet të jemi të mbrojtur ndaj keqpërdorimit të këtij pushteti.”

Gazetarët, ashtu si gjithë të tjerët, mund të gënjejnë dhe mund të fusin hundët. Mediat vendase dhe ato ndërkombëtare botojnë dhe transmetojnë informacion për njerëzit, duke e amplifikuar impaktin e këtij informacioni. Megjithatë, ky nuk është argument për të censuruar lirinë e fjalës. Në fakt, ky është një argument akoma më i fortë për lirinë e fjalës: aftësia për t’iu kundërvënë kritikave nëpërmjet debatit publik.

Gazetarët mund të mbledhin më shumë informacion se kushdo tjetër gjatë punës së tyre. Këto informacione apo pamje mund t’i botojnë apo transmetojnë në media me lexueshmëri apo shikueshmëri masive. Ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të mos i zënë besë një gazetari; gazetari nuk do të jetë patjetër ai që do të përmirësojë imazhin dhe as miku yt më i mirë. Megjithatë, ndryshe nga autoritetet shtetërore, gazetarët nuk grumbullojnë informacion për çdo individ në fshehtësi. Instinkti i medias është ta botojë informacionin dhe pamjet. Kjo gjë mund të mos jetë e favorshme për subjektin e artikullit – por bëhet fjalë vetëm për fjalë dhe pamje, të cilat mund të përgënjeshtrohen publikisht apo mund të shpërfillen.

Një aspekt që duhet vënë në dukje i ankesave bashkëkohore për dhunimin e privatësisë nga media është se shpesh ato përfshijnë edhe ankesa për pasqyrimin e aktiviteteve që

janë zhvilluar në hapësira publike. Të fotografohesh në një plazh pa dijeninë tënde apo të të botohen fotot e një darke intime në median kombëtare mund të jenë acaruese. Por a do të thotë kjo që nuk duhet lejuar kjo gjë? Ku vihet kufiri?

### ***Rrymat e tanishme të privatësisë: Përmbajtje apo ekspozim?***

Në thelbin e debatit për shprehjen e lirë dhe privatësinë gjenden pyetje që kanë të bëjnë me vlerat themelore demokratike dhe me ndjenjat tona më personale. Të gjithë ne kemi pikëpamje të ndryshme për ato që duam t'i mbajmë private dhe për ato që jemi të përgatitur t'i ndajmë me publikun. Disa njerëz duan ta mbajnë jetën private për vete; të tjerë i shfaqin emocionet në publik për famë dhe para. Tashmë vërehet shpesh se diskursi publik po mbështetet gjithmonë e më shumë në rrëfime private – për shembull, diskutimi i jetëve private të politikanëve dhe personave të njohur.

Debatet e tanishme për privatësinë dhe median ngrenë një sërë pyetjes. A është e mundur të gjykohet nëse ajo që shkruan apo thua do të shkaktojë dëme emocionale? Si mund të përcaktosh atë për të cilën njerëzit nuk mund të flasin apo shkruajnë, nuk mund ta filmojnë apo ta fotografojnë, pasi është një çështje private? Ku bëhet ndarja në këto raste? Një përpjekje për ta qartësuar këtë gjë do të ishte: për sa kohë që privatësia kuptohet si një e drejtë e personave fizikë – jo e qeverive apo e korporatave – dhe për sa kohë që privatësia nuk përkthehet si sinonim për fshehtësi, atëherë privatësia është një vlerë që gazetaria duhet ta mbrojë, pjesërisht për të mbrojtur edhe vetveten.

Sigurisht që dy vlerat – privatësia dhe rrëfimi; maturia dhe ekspozimi – bien ndesh me njëra-tjetrën në rrethana të caktuara. Duhet ruajtur disa ekuilibra. Duhet bërë kompromise. Por këto janë gjëra të përditshme në punën e gazetarëve dhe kryeredaktorëve. Gazetarët, të cilët punojnë edhe nën presionin e afateve kohore, kundërpeshojnë përditë vlera të tilla si privatësia me interesin publik për të ekspozuar informacionin.

A do ta shfaqë producenti televiziv atë segment të aksidentit ku një viktimë është në gjendje të pahijshme apo të shqetësuar? Ky lloj peshimi i gjendjes është një pjesë themelore e punës të gazetarëve që janë të denjë për këtë emër. Përndryshe, çfarë tjetër është kjo veçse respekti për privatësinë? Në fakt, respekti i privatësisë nuk duhet të jetë i panjohur për gazetarinë, por duhet të jetë pjesë përbërëse e saj.

Kur bëhet fjalë për privatësinë dhe median, është praktikë që gazetarët argumentojnë se publiku ka të drejtën ta dijë diçka dhe se interesi publik është më i madh se interesat për privatësi të personit të përfshirë. Por ky argument përdoret edhe pa kritere dhe në mënyrë të nxituar.

Nuk ekziston një kufi i qartë mes asaj që është private dhe asaj që nuk është e tillë. Përdorimi i termit “publik” shpesh është një metodë e mirë për të vënë kufij, por ekziston një hapësirë e madhe midis asaj që është domosdoshmërisht publike dhe asaj që është domosdoshmërisht private ... Testi nëse ekspozimi apo marrja e informacionit apo e një veprimi të caktuar do të ishte mjaft fyese për një person të arsyeshëm, me ndjeshmëri të

zakonshme, në shumë rrethana mund të jetë një test i dobishëm praktik për atë që është private.

Si mund ta përdorin dhe përshtatin gazetarët këtë test në kundërpeshimin e përditshëm mes privatësisë dhe ekspozimit në lidhje me njerëzit që përbëjnë lajm? A është më i madh interesi publik për të ekspozuar apo interesi për privatësi i personave të përfshirë?

Edhe konceptimi bashkëkohor i privatësisë është problematik. Privatësia, në kuptimin e saj tradicional, do të thotë të jesh i lirë nga ndërhyrjet e shtetit në jetën private. Por gjatë dekadave të fundit, beteja për të përkufizuar privatësinë është bërë më e paqartë. Sot, koncepti i privatësisë mund të thuhet se është bërë më i paqëndrueshëm dhe më i vështirë për t'u përkufizuar.

Çështja e privatësisë dhe e lirisë së shtypit në vitet e fundit është komplikuar edhe më shumë nga zhvillimi i një prirjeje tjetër – më qartë, fiksimi me jetën private të njerëzve edhe në debatin publik dhe në jetën kulturore. Shumë nga ata njerëz që janë aktivistë të lirisë së fjalës në fakt nuk iu intereson aspak të lexojnë për jetët private të futbollistëve. Po fakti që shitjet e revistave që merren me njerëzit e njohur janë rritur a do të thotë që disa përpjekje apo veprime të supermodelëve apo njerëzve të njohur duhet të kenë statusin e lajmeve serioze?

Fakti që debati publik gjithnjë e më shumë po përqendrohet në jetën private është padyshim problematik. Duke ngatërruar publikun me privaten, kultura e ditëve tona vë në rrezik idenë e “interetit publik.” Popullariteti i gazetarisë të orientuar nga jeta personale dhe nga rrëfimet personale kërcënon lajmet dhe debatet me gamë të gjerë, të cilat përbëjnë themelin e një kulture progresive, të hapur dhe demokratike. Por, as censura e këtyre ligjëratave për hir të “balancimit” të së drejtës së fjalës me të drejtën për privatësi apo dëmtimin emocional nuk është një zgjidhje.

Për shumë vite, gazetarët i kanë bazuar ato që kanë menduar se duhet të botohen apo transmetohen në diktatin se “ajo që mund të jetë me interes për publikun nuk është doemos në interesin publik.” Ideja e interesit publik zakonisht është lidhur me çështje të politikave publike apo me çështje me rëndësi sociale. Megjithatë, tashmë asnjë nuk bie dakord me një përkufizim të vetëm të interesit publik.

Megjithatë, sado problematik të ketë qenë përdorimi i “interetit publik” me qëllime censure, kur vjen puna te standartet e gazetarisë, ky është një nocion që vlen të ruhet. Përse? Si e komentoi Stuart Kuttner, menaxher i *News of the World*, në një intervistë në 1998: “E vërteta nuk duhet të shtypet apo të censurohet. Megjithatë, thjesht sepse diçka është e vërtetë, nuk do të thotë patjetër që kjo është me interes publik, edhe pse mund të jetë interesante për publikun. Ky nuk është argument për censurë; është argument për një shoqëri të civilizuar dhe të pjekur.”

## **Situata e çështjeve të privatësisë në median shqiptare**

Në Shqipëri nuk ka ligje specifike për median e shkruar. Me përjashtim të ligjeve dhe rregullave që kanë të bëjnë me median si biznes, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha kompanitë në vend, nuk ka ligje të posaçme që lidhen me përmbajtjen për median e shkruar. Gjendja është ndryshe për median elektronike, e cila ka një rregullim relativisht të hollësishëm. Megjithatë, as media elektronike nuk ka rregullim të posaçëm për nocionin e privatësisë si të tillë, me përjashtim të rekomandimeve të përgjithshme për mbrojtjen e dinjitetit të individëve. Pra, edhe pse ky boshllëk ligjor krijon më shumë hapësirë për lirinë e shprehjes, ai gjithashtu rrit mundësinë për të abuzuar me këtë liri.

Në këtë kontekst, balanca mes lirisë dhe përgjegjshmërisë duhej të arrihej me anë të vetë-rregullimit të medias. Megjithatë, në Shqipëri ky proces është ende mjaft i dobët. Edhe pse në parim ekziston një konsensus i përgjithshëm për nevojën e krijimit të mekanizmave vetë-rregulluese, në praktikë këto mekanizma nuk ekzistojnë ende. Në median shqiptare kodi i etikës tashmë është krijuar prej më shumë se 10 vitesh, por pa mbikqyrjen e një mekanizmi vetë-rregullues, zbatimi i rregullave etike i lihet në vullnet të lirë vetë mediave.

Megjithatë, ky kod etike ka një kapitull të veçantë për çështjet e privatësisë, i cili thotë si më poshtë:

- **Ndërhyrja në jetën private të njerëzve**

Gazetarët duhet të respektojnë nderin dhe reputacionin e individëve që bëhen objekte të interesit të tyre profesional.

Gazetari nuk ka të drejtë të ushtrojë shantazh ose të ofrojë shpërblim në shkëmbim të informacionit. Në rastet kur pagesa është e nevojshme për të marrë informacionin që publiku ka të drejtë të dijë, kjo duhet bërë e qartë në raportim.

Gazetari duhet të respektojë të drejtën e individëve për privatësi. Vetëm mbrojtja e interesit të shoqërisë mund të justifikojë hetimet gazetareske që ndërhyjnë në jetën private të personit.

Gazetarët duhet të përdorin kamerat e fshehta / mikrofonat, identitetin e rremë, ose të mos bëjnë të ditur identitetin e tyre profesional vetën në rast se këto janë mënyra e vetme për të zbuluar informacione me rëndësi jetike për interesin publik; metodat e përdorura duhet të bëhen të ditura gjatë raportimit.

Gazetarët nuk duhet të tërheqin kurrë vëmendjen ndaj aspekteve personale ose private nëse ato nuk janë të rëndësishme.

Përdorimi “i beftë” i kamerave në publik apo institucione duhet të bëhet duke respektuar dëshirën dhe ndjeshmërinë e të pranishmëve.

Figurat publike kanë më pak të drejtë për privatësi; megjithatë, informacioni mbi jetën e tyre private mund të bëhet i njohur vetëm nëse përbën interes publik.

Ndërsa ky kapitull i kodit i kushtohet posaçërisht ndërhyrjes së medias në jetën private, edhe kapituj të tjerë që përqendrohen te pasqyrimi i kronikës së zezë, aksidenteve, fatkeqësive, si dhe te fëmijët dhe njerëzit e dobët, gjithashtu e trajtojnë problemin e ndërhyrjes në jetën private dhe të drejtën për të pasur dinjitet. Kapitujt e mëposhtëm janë veçanërisht të rëndësishëm në kontekstin tonë:

- **Krimi dhe dhuna**

Dhuna dhe brutaliteti nuk duhen sensacionalizuar. Raportimi duhet të marrë parasysh nevojën për të mbrojtur të miturit.

Media duhet të tregojë vetëpërmbytje në raportimin e krimeve të të miturve dhe në proceset gjyqësore ndaj tyre, për të mos cënuar të ardhmen e të miturve në fjalë. Ky rekomandim vlen edhe për raportimin mbi viktimat e krimit që janë në moshë të mitur.

Media duhet të shqyrtojë me kujdes nëse është me vend të botohen faktet për skandalet familjare apo të kujtojë krimin e vjetër të kryer nga një individ që e ka shlyer dënimin e tij.

Media duhet të tregojë maturi në identifikimin e viktimave apo dëshmitarëve në krime, sidomos në rastet e dhunës seksuale, me përjashtim të rasteve kur është marrë pëlqimi i tyre për t'u identifikuar.

- **Aksidentet dhe fatkeqësitë**

Gazetarët duhet të respektojnë të drejtën e njerëzve për të mbajtur zi dhe duhet t'i raportojnë këto tema duke treguar simpati dhe vetëpërmbytje.

Në rast aksidentesh dhe fatkeqësish, gazetari duhet të respektojë vuajtjet e viktimave dhe ndjenjat e familjeve të tyre.

Media duhet të tregojë maturi me fotot apo pamjet e katastrofave, aksidenteve apo dhunës në rast se ato fyejnë ndjenjat e të afërmeve. Media duhet të ketë në konsideratë ndjeshmërinë e publikut gjatë këtyre raportimeve.

Nuk duhen identifikuar viktimat apo personat e zhdukur nëse të afërmit nuk janë informuar.

- **Fëmijët dhe njerëzit e dobët**

Gazetari mbron të drejtat dhe dinjitetin e fëmijëve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe të drejtën e tyre për t'u dëgjuar.

Gazetarët nuk duhet të përfitojnë nga pafajësia dhe besimi i fëmijëve dhe mund të botojnë informacione apo pamje të jetës private të një fëmije vetëm në rast se kjo është një domosdoshmëri e interesit publik.

Gazetarët nuk duhet të intervistojnë fëmijët nën moshën 14 vjeç për çështje personale, në mungesë ose pa pëlqimin e prindërve, ose personave përgjegjës për fëmijën.

Këto rregulla të Kodit të Etikës padyshim që nuk janë shteruese për të gjitha dilemat që rrethojnë debatin rreth medias dhe jetës private. Megjithatë, ato kanë për qëllim të shërbejnë si udhëzues të përgjithshëm në këto dilema. Si u përmend dhe më sipër, Kodi si i tillë nuk ka forcë detyruese, duke pasur parasysh që Kodi është miratuar në parim, por nuk ka pasur një firmosje apo mbështetje kolektive të këtij Kodi. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin që këto janë udhëzimet e vetme në median shqiptare deri në këtë pikë, do të ishte me dobi të shihej se si media shqiptare sillet në praktikë në lidhje me këto standarde që vendos Kodi. Monitorimi i medias së shkruar për çështje të lidhura me privatësinë është një ushtrim i dobishëm jo vetëm për të identifikuar prirjet kryesore në këtë aspekt, por edhe për të vënë në provë profesionalizmin e medias në lidhje me çështjet e privatësisë.

### **Metodologjia**

Me qëllim që të kemi një kuptim më të mirë të mënyrës se si media sillet në lidhje me jetën private, një monitorim i pesë gazetave të përditshme kryesore u krye në muajin mars 2009. Gazetat e përditshme i përkisnin mediave kryesore dhe u përzgjedhën ato që mendohen se kanë numrin më të madh të shitjeve apo gazeta që kanë një lloj ndjeshmërie në debatin e përgjithshëm për median dhe privatësinë. Meqë nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për shitjen e gazetave dhe tirazhin e tyre në përgjithësi, përzgjedhja e gazetave për monitorim u bazua te këshillimet me kryeredaktorët e gazetave të përditshme. Gazetat e monitoruara janë: *Shekulli*, *Panorama*, *Gazeta Shqiptare*, *Korrieri*, dhe *Shqip*. Meqë jeta private nuk është temë më vete, gjatë këtij muaji u monitoruan të gjithë artikujt e botuara në këto gazeta dhe u përzgjedhën ata artikujt që ishin interesant ose që ngrinin pikëpyetje për jetën private dhe u analizuan më tej. Meqë jeta private nuk është një rubrikë më vete në gazeta, analiza ishte vetëm cilësore dhe jo sasiore. Analiza që vijon trajton me hollësi prirjet kryesore që u vërejtën gjatë monitorimit.

#### ▪ ***Pasqyrimi i zisë***

Mënyra se si u drejtohet media njerëzve në raste zije, aksidentesh apo fatkeqësish të tjera dhe mënyra se si kjo i përçohet publikut, janë mjaft domethënëse për nivelin etik të medias dhe gazetarëve. Në përgjithësi, gazetarët shqiptarë nuk duket se kanë probleme në marrjen e intervistave nga viktimat, dëshmitarët apo të afërmit e viktimave apo keqbërësve, ndonjëherë edhe nga vetë keqbërësit. Ky është një aspekt që e bën më kompleks pasqyrimin e kronikës së zezë; megjithatë, jo gjithmonë ky pasqyrim është etik ndaj të intervistuarve dhe informacioni jo gjithnjë është me rëndësi jetike për publikun.



Gjatë monitorimit pati tre raste kryesore zije dhe vdekjesh: mbytja e dy peshkatarëve, vdekja e një foshnje si pasojë e zjarrit dhe vdekja e një nëne dhe dy fëmijëve të saj pas djegies së shtëpisë. Në rastin e parë, ishte e qartë që gazetarët kishin vajtur në shtëpitë e viktimave dhe kishin intervistuar kunatin e njërit prej viktimave, duke përshkruar situatën e dhimbshme. Gjithashtu, të gjitha gazetat kishin botuar foto të dy shtëpive dhe të personave që prisnin në radhë për të ngushëlluar familjet e viktimave, si dhe foto të dy të vdekurve. Pyetja që lind pasi lexon këto artikuj dhe sheh këto pamje është: çfarë kanë kaq thelbësore këto pamje që duhen patjetër të botohen në gazetë? A mund të bënte publiku pa këto pamje në një kohë kur njerëzit në zi janë shqetësuar për t’iu marrë informacion dhe fotot? Çfarë ka kaq të veçantë te një tufë njerëzish që presin të hyjnë në shtëpinë e viktimave për të ngushëlluar familjen sa kjo foto duhet botuar në gazetë? Është e qartë që disa gazeta kanë menduar se kjo ishte një pamje që duhej pasur. Padyshim që nuk ka një shpjegim të saktë apo një përgjigje të caktuar nëse gazetat kanë vepruar drejt; megjithatë, është e vështirë të dallohet qoftë edhe një fije interesi publik në këtë rast që do të justifikonte botimin e këtyre pamjeve.

Rasti i dytë është rasti i vdekjes së një foshnje në zjarrin që përpiu shtëpitë ndërsa prindërit ishin larguar. Në këtë rast, një nga gazetat botoi një intervistë të zgjeruar me të atin e fëmijës, si dhe foto të babait, të grave që mbanin zi dhe të shtëpisë që ende lëshonte tym.

**TEPELENE/ Kryefamiljari: E pashë me sy vdekjen e tim biri**

# Digjet i gjallë foshnja, i mbijeton zjarrit e motra

*Tragjedia, prindërit harruan ndezur sobën e druve*

Eri Baco  
Ismail Khaferi

TEPELENE

**F**lakët e zjarrit shkaktojnë tragjedi në Tepelene. Një shtetë i vitit 6 muaj është djegur i gjallë, ndërsa ka mbijetuar motra e tij 5 vjeçe. Lenia e sobës së druve ndezur i ka kushtuar shumë shtrenjtë familjes Bega. Përveçse humbjes së djalit të mitur dhe plagosjes së vajzës, bashkëshortët Bega kanë mbetur të nastrohë si



Aleksandër Bega, babai i djalit që u dogj i gjallë nga zjarri.



Familjarë të viktimave



Shtëpia e familjes Bega

**VAJZA**  
Fati deshi që t'i mbijetonte vdekjes 5-vjeçarja Silvana Bega. E mitura ndodhet nën kujdesin e mjekëve, ndërsa pranë saj ka nusen e xhaxhait. Teksa iu afruan afër

basesën që ishte përfshirë e gjitha nga flakët. Djali i dajës më tregoi vajzën tme 5 vjeçe që mbante për dore, ndërsa djali im kishte mbetur brenda.  
Çfarë bëre në atë moment?  
Vura një batanije në kokë dhe u turra për të hyre brenda. Të afërmit më kapën për kraresh dhe më larguan,

Madje artikulli kishte dhe një përshkrim të gjallë të gjithë ngjarjes:

*“Vetëm pak orë pas tragjedisë, kreu i familjes, Aleksandër Bega, deklaroi për ‘Gazeta Shqiptare’ se si i pa flakët që në mënyrë tragjike i morën jetën të birit. Me mjekrën që i dridhet nga lotët, tha se nuk kishte mundur të futej mes flakëve dhe të shpëtonte jetën e të birit.”<sup>2</sup>*

Në këtë rast, është e qartë që gazetarët menduan se kjo ndërhyrje në zinë e një familjeje dhe të një babai ishte mëse e justifikueshme dhe se ishte shumë e rëndësishme të merrnin

<sup>2</sup> “Digjet i gjalle foshnja, i mbijeton zjarrit e motra,” Gazeta Shqiptare, 20.03.3009, f. 20.

këtë intervistë. Natyrisht, është e qartë që babi fare mirë mund të mos kishte rënë dakord për intervistën. Megjithatë, është gjithashtu e qartë që gazetarët po intervistojnë një baba që po mban zi dhe që po qan ende për humbjen e tij ndërsa flet me ta dhe gjithashtu është e qartë që për gazetën ky nuk është aspekti më i rëndësishëm dhe nuk është një moment privat; në fakt, sipas gazetës duhet të jetë një moment që ky njeri duhet ta ndajë me të gjithë publikun. Deri në atë pikë sa gazeta vë në dukje dhe krenohet me faktin që ky njeri vendosi të flasë me gazetën vetëm pak orë pas tragjedisë, ndërkohë që fokusi ishte diçka shumë më e dhimbshme sesa kush merr intervistën e parë nga një familje që po kalon një dhimbje të madhe. Në këtë rast, është e qartë të shihet se përse ka njerëz që do të kishin kureshtje ta lexonin këtë artikull dhe të lexonin fjalët e këtij burri apo të shihnin dhimbjen e tij; megjithatë, kjo mbetet në kufijtë e diçkaje interesante për t'u lexuar dhe jo të diçkaje që duhet patjetër të bëhet e njohur për hir të publikut.

Një tjetër rast i qartë ndërhyrjeje në zi është një artikull tjetër që pasqyron një vrasje në kryeqytet, si pasojë e një zënke banale. Pasi jepen faktet dhe hollësitë kryesore, artikulli përqendrohet kryesisht te zia e nënës, duke u ndalur te dhimbja, gjestet e gjëra të tjera të ngjashme:

*“Plumbat ma morën djalin. E kisha si flori, e shkreta unë.” E ëma nuk mund të shkonte në varrim. Të gjitha mendimet e saj duket se janë përqendruar te vrasja e djalit të vogël. Gruaja është ulur në një karrige të vogël në qoshe të dhomës. Dridhet dhe tregon me dorë diçka, ndërsa muskujt e faqeve i lëvizin me shpejtësi. Dhimbja e saj nuk mund të përshkruhet. Ndërsa lotët i rrokullisen faqeve, ajo mundet vetëm të pëshpëritë: “E shkreta unë, nuk më del shpirti. Ç’ta bëj jetën pa djalin?!” Rrëfimi i saj i shkurtër nuk është më pak i dhimbshëm: “Shkëlqimi doli dje për një kafe në lagje. Tha se nuk do të vonohej,” thotë ajo. Pastaj dëgjuam lajmet në TV, që thonin se e kishin vvarë.*

Edhe në këtë rast, është e qartë që gazetarët kanë vajtur të intervistojnë një nënë që po mban zi, e cila është ndoshta në momentin më të vështirë dhe të dhimbshëm të jetës. Ndërkohë që nuk ka dyshim që përshkrimi i gjendjes së saj, hollësitë dhe citimet e bëjnë dhimbjen më të vërtetë dhe të prekshme për lexuesin, duhet bërë edhe një pyetje tjetër: a ishte e nevojshme gjithë kjo? Kur vjen puna për informacionin për artikullin, asgjë nga këto që thotë e ëma e viktimës nuk hedh dritë mbi ngjarjen dhe arsyet pse ajo ndodhi. E vërteta është që artikulli fiton më shumë nga ana njerëzore në krahasim me një artikull që do të bazohej te deklarata e policisë, por është gjithashtu e vërtetë që një grua që po përjeton një dhimbje ekstreme u shqetësua me qëllim që të japë informacion që merret me mend vetë nga publiku, d.m.th. që e ëma po mban zi për të birin. Pra, dilema nëse këto ndërhyrje në dhimbjen e njerëzve janë të justifikueshme apo jo mbetet.

Një linjë e ngjashme u ndoq edhe në pasqyrimin e vdekjes së një nëne dhe dy fëmijëve të saj si pasojë e shpërthimit dhe djegies së shtëpisë. Ata ishin emigrantë në Itali, ndërsa të afërmit jetonin në Shqipëri. Kjo ngjarje u pasqyrua gjerësisht pothuajse nga të gjitha gazetatat e përditshme kryesore të monitoruara dhe të gjitha ato kishin vajtur te shtëpia e të afërmeve, ku priteshin edhe kufomat për varrimin. Gazetat botuan foto të dy fëmijëve, si dhe të nënës së tyre, foto që ishte e qartë që mund të ishin marrë vetëm te të afërmit e

tyre. Gjithashtu u botuan edhe foto të shtëpisë dhe foto të grave në zi, të veshura me të zeza, si dhe foto të gjyshes që i priste ata. Ishte e qartë që gazetarët kishin vajtur në shtëpi, kishin marrë fotot për botim dhe gjithashtu kishin intervistuar personat që gjendeshin aty në shtëpi, ku mbahej zi. Fotot e mëposhtme ishin disa nga ato që u botuan për këtë rast në gazeta:



Fotot e mëposhtme patjetër që u japin një fytyrë viktimave dhe publiku mund ta ndjejë më shumë tragjedinë dhe të ndjejë keqardhje për viktimat dhe të afërmit e tyre. Megjithatë, është e qartë që për të marrë këto foto janë shqetësuar të afërmit e viktimave, duke i dhënë përparësi asaj që është interesante për publikun dhe jo të drejtës së familjes për të mbajtur zi pa ndonjë ndërhyrje.



**gjyshja e dy fëmijëve, Zoje Gonaj**



**Në shtëpinë e familjes Gonaj**

Fotot e mësipërme gjithashtu vijnë nga shtëpia që është në zi dhe portretizojnë gjyshen e dy fëmijëve të vdekur dhe gratë që vajtojnë. Sërish, është e qartë prania e medias në shtëpi. Ajo që nuk është aq e qartë është nëse këto foto i sjellin ndonjë gjë të re informacionit të dhënë tashmë. Pamje të tilla mund të gjenden në çdo familje që është në zi, pavarësisht sesa e rëndë është ngjarja. Pra, a është e pranueshme që media të shkojë dhe të marrë foto të njerëzve që mbajnë zi, për të botuar këto foto dhe për të intervistuar njerëzit që janë në momentet më të vështira?

Për shembull, gjyshja u intervistua nga gazetarët dhe shprehte dhimbjen e saj: “Si mund të jetoj kur mendoj se djali po më digjej, se e prisnin shokët në autobus për të vajtur për të luajtur. Djali më kish premtuar se këtë verë do i sillte në Shqipëri dhe do të rrinin der në

shtator,' thotë gjyshja me mjekrën që i dridhet.”<sup>3</sup> Në këtë rast dhimbja e saj është sjellë më pranë publikut dhe mund të thuhet që gazetarët kanë bërë një punë të mirë në përcimin e gjendjes së kësaj familjeje. Megjithatë, a ia vlen kjo gjë? A mund të kishte bërë publiku edhe pa këtë informacion dhe a mund të ishte lënë e qetë familja e viktimave pa humbur ndonjë informacion thelbësor?

Një tjetër rast i rëndë gjatë këtij monitorimi që duhet vëzhguar përsa i përket çështjeve të privatësisë është mbytja e dy peshkatarëve. Ky nuk ishte një rast që pati aq pasqyrim në media sa vdekja e nënës dhe dy fëmijëve. Megjithatë, skema është e ngjashme: peshkatarët kishin humbur për disa ditë pas një furtune dhe kur u gjetën trupat, edhe media vërshoi në shtëpitë e tyre për të raportuar për gjendjen. Çfarë të reje apo lajmi ka te mbajtja zi për të vdekurit?



Si e tregojnë dhe këto foto, nuk ka ndonjë të re. kemi po të njëjtat foto nga afër të fytyrës së viktimave, një rrugë fshati ku është shtëpia e tyre, një varkë të mbytur si dhe grupe njerëzish që presin radhën për të ngushëlluar të afërmit e viktimave.

Për më tepër, këto artikuj sjellin dhe fjalët e të pranishmëve për vështirësitë që kishte çdo familje. Më konkretisht: “Josif Rudha, kunati i Vangjelit, na thotë se i ndjeri kishte gjashtë fëmijë. Një nga djemtë kishte qenë emigrant në Greqi dhe tani ishte me depression.”<sup>4</sup> Ose: “Familja e Stavrit përbëhet nga tre vajza të vogla dhe e shoqja, për të cilën na thonë se është sëmurë. Ai punonte për të mbajtur gjallë familjen, e cila është e varfër.” Në këtë rast, jo vetëm që ka pasur ndërhyrje në të afërmit që mbajnë zi, por gazeta ka paraqitur edhe një këndvështrim sentimental të viktimave dhe familjeve të tyre, duke ia bërë të qartë gjithë publikut që ata kishin probleme të mëdha. Kështu, ekspozimi i një familjeje që ka një njeri që është i sëmurë mendor nuk mund të jetë një veprim aq korrekt i medias dhe në këtë rast nuk është as shumë i rëndësishëm. Lajmi është që këta njerëz vdiqën dhe jo që djali i viktimës është i sëmurë mendor.

<sup>3</sup> “Nusja e femijet shkuan me gomone, u dogjen te gjalle,” *Gazeta Shqiptare*, 03.03.2009, f. 15.

<sup>4</sup> “Deti nxjerr trupat pa jete te dy peshkatarëve,” *Korrieri*, 07.03.2009, f.12.




Këto prirje për të marrë nën mbrojtje apo për të ndjerë keqardhje viktimat janë të kuptueshme deri në një pikë, pasi gazetarët njihen me personat që janë në zi dhe është njerëzore që gjendja shpirtërore të ndikohet nga ajo që shohin. Megjithatë, të vësh në qendër të vëmendjes problemet dhe vështirësitë e viktimave dhe të të afërmeve të tyre nuk është gjithmonë e dobishme dhe e këndshme për këta të fundit. Për më tepër, a është e dobishme për të tjerët, apo është thjesht interesante?!

Pra, sërisht, dilema e ndërhyrjes është e qartë: a duhet gazetarët të shkojnë dhe të shqetësojnë familjen e viktimës në momente të tilla për të marrë versionin e tyre të ngjarjes, në një kohë që versioni i tyre është vetëm emocional dhe nuk sjell ndonjë informacion të vërtetë, të nevojshëm apo të panjohur për publikun? Ky është një vendim që secila redaksi duhet ta bëjë vetë dhe deri tani duket se jeta private është më pak e rëndësishme sesa marrja e hollësive (të rëndësishme dhe jo aq të rëndësishme) për publikun.

#### ▪ *Pasqyrimi i njerëzve të dobët*

Shqetësime të tjera, ndoshta më të rënda, në lidhje me pamjet kanë të bëjnë me mënyrën se si fotot sigurohen, sidomos në aspektin e ndërhyrjes në jetën private të familjeve apo viktimave. Fotot e përdorura në këto raste vijnë nga tre burime: ilustruese, nga arkivat e redaksive, nga policia, apo merren nga viktimat apo familjet e tyre. Ndërkohë që nuk duket se ka ndonjë problem përgjithësisht me dy burimet e para, fotot e marra nga viktimat apo familjet janë pak më të diskutueshme dhe meritojnë më shumë vëmendje. Për shembull, ky monitorim nxorri në pah disa raste të njerëzve të lënduar apo viktimave që ishin në spital në momentin kur po raportohej. Shumë raportime të tilla botuan edhe foto të viktimave në spital, ndërkohë që viktimat ishin në koma apo ishte e qartë që nuk ishin në gjendje të flisnin apo të dilnin në publik. Për shembull, në çështjen e gruas që ishte qëlluar në kokë nga i shoqi, i cili më pas kishte vrarë veten, janë botuar disa foto, ku ajo është e shtrirë në shtratin e spitalit, me të nxira, duke mbuluar fytyrën me dorë në një rast apo e mbuluar me batanije në foton tjetër, ndërkohë që të afërmit i rrinë pranë. Fotot e mëposhtme janë një përzgjedhje e pamjeve të botuara në këtë ngjarje të rëndë në gazeta në monitorim:



Njëra nga gazetatat gjithashtu kishte botuar një foto edhe të kufomës së mbuluar të të shoqit në morgun e qytetit. Përveç reagimit të menjëhershëm publik që këto foto shkaktojnë te lexuesit, pyetja që vijon është se cili është qëllimi i botimit të këtyre fotove dhe si lidhen ato me interesin publik? Edhe nëse ekziston sadopak interes publik, si baraspeshohet ai me dhimbjen që kjo grua dhe të afërmit e saj po kalojnë? A është i justifikueshëm ky interes publik në fund të fundit?

Edhe pse ky rast ishte një nga më flagrantët, ndërhyrja e medias nëpër spitale ka qenë një fenomen që ka qenë i pranishëm shpesh në artikujt e monitoruar. Kështu, fotoja e parë e paraqitur këtu është ajo e një gruaje të vjetër e cila përfundoi në spital pasi i biri e rrahu për një mosmarrëveshje për pronat<sup>5</sup>. Artikulli përshkruan gjendjen e keqe të gruas së moshuar kur ajo arriti në spital, duke e ilustruar edhe me një foto. Ndërsa është e qartë për publikun nga fotoja se gjendja shëndetësore është e rënduar, kjo gjë bëhej e qartë edhe thjesht duke lexuar artikullin dhe nevoja për të botuar një pamje të tillë të një njeriu që po vuan është e diskutueshme nga pikëpamja etike.



Fotoja e dytë është ajo e një djali 13-vjeçar, i cili është goditur me thikë nga një shoku i vet<sup>6</sup>. Fotoja tregon njerëz (me shumë mundësi prindërit e tij), të cilët rrinë në këmbë pranë shtratit, ndërkohë që doktorët po vizitojnë një nga pacientët në foto. Fotografia në një artikull mendohet të jetë ndoshta gjëja e parë që të bie në sy. Megjithatë, kjo foto tregon një skenë normale në çdo spital ku mund të hysh, pa ndonjë rëndësi të veçantë për ngjarjen. Pra, fotografia duket se thjesht e kompletion ngjarjen dhe nuk është një element thelbësor i saj. Ndërkohë, njerëzit që janë në vuajtje shqetësohen nga prania e gazetarëve dhe fotografëve, apo e personave të tjerë që përpiqen të raportojnë për median. Pyetja e pashmangshme është: a është e nevojshme kjo gjë apo jo?

<sup>5</sup> “Rreh për vdekje nënën, s’i jepte firmën për token,” *Shekulli*, 24.03.2009, f.9.

<sup>6</sup> “Plagoset me thike nxënësi 13 vjeç,” *Shqip*, 10.03.2009, f.22.



E njëjta pyetje mund të ngrihet edhe për foton e mësipërme, e cila tregon një baba që i ka dhuruar veshkën të bijës në transplantin e parë të veshkës të bërë në vend. Ku është interesi publik i të parit dikë që është shtrirë në një shtrat spitali dhe po merr veten nga një operacion? Edhe pse ky është rasti i parë i tillë, sërish, nuk ka asgjë të veçantë në këtë foto dhe personi nuk është njeri publik. Ndërkohë që ka shumë njerëz që mund t'u pëlqejë kjo famë e papritur, nuk ka asnjë tregues që gazetarët kanë marrë leje për këtë gjë; në këtë rast ata as mund të marrin leje. Pra, megjithë nuancat e ndryshme, çështja e ndërhyrjeve nëpër spitale për të marrë foto të të sëmurëve dhe të ë afërmeve të tyre është një praktikë relativisht e përhapur. Kjo është një praktikë që vihet re kryesisht në spitalet e rretheve sesa në ato të Tiranës dhe stafi i spitalit ka përgjegjësinë e vet në këtë drejtim. Megjithatë, ky është një problem që mediat duhet ta trajtojnë në testet etike për vetveten, sa më shpejt, aq më mirë.

#### ▪ *Media dhe njerëzit publikë*

Edhe pse privatesia është një koncept kompleks dhe është i vështirë për t'u përkufizuar, ekziston një marrëveshje e përgjithshme në lidhje me jetën private dhe median: e drejta e njerëzve publikë për jetë private është më e kufizuar se ajo e njerëzve të zakonshëm. Në fakt, gazetaret kryesorë shqiptarë e madje edhe ato më të vogla, tashmë botojnë suplemente të rregullta për veprimet apo edhe thjesht thashethemet që ekzistojnë për njerëzit e njohur. Këtu nuk hyjnë vetëm zyrtarët publikë, por edhe ata që mund të konsiderohen si të famshëm. Këto lloje botimesh padyshim që përbëjnë një risi në media. Megjithatë, shpesh ndodh edhe që edhe të ashtuquajturat gazeta "serioze" apo gazeta kryesore merren me thashetheme. Për më tepër, mënyra se si ndërtohen këto faqe, burimet e informacionit të përdorur, mënyra se si është marrë informacioni, janë interesante për të parë se si media i trajton personat publikë kur vjen puna te jeta private.

Me qëllim që të analizohen këto prirje. Monitorimi u përqendrua te dy persona publikë: ish-Ministri i Kulturës dhe i biri, si dhe një nga finalistët e programit "Big Brother Albania." Në rastin e parë, interesi publik është i padiskutueshëm: pas transmetimit të një video që tregonte se ministri kishte kërkuar shërbime të një natyre seksuale në shkëmbim të vendit të punës, të gjitha gazetaret dhe mediat në përgjithësi e pasqyruan gjerë këtë ngjarje, dhe me të drejtë.

Megjithatë, disa media nuk u mjaftuan me ish-Ministrin, por përfshinë edhe të birin, pa dëshirën apo lejen e këtij të fundit. Një nga gazetat<sup>7</sup> ishte futur në faqen e Facebook të të birit pas skandalit, duke përshkruar dhe bërë publike aktivitetin e tij, si dhe duke botuar në gazetë foto nga kjo faqe:



Artikulli thotë: “*Shekulli* ka shkëputur vetëm tre data nga faqja personale e Viktorit, të cilat i përkasin momenteve para dhe pas skandalit” dhe më pas vazhdon të përshkruajë aktivitetin e djalit të Pangos dhe gjendjen e tij shpirtërore pas shpërthimit të skandalit. Autori i artikullit vazhdon me përshkrimin se sa e lehtë është të bëhesh mik i djalit të ministrit në Facebook, duke thënë se ai është i etur për miqësi, duke numëruar sa miq ka, cili është komunikimi mes tyre, etj. Në këtë rast është e qartë që ose gazetari është bërë mik me djalin e Pangos dhe më tej e ka përdorur informacionin për të shkruar artikullin, ose që faqja e djalit të Pangos është publike dhe aty mund të hyhet pa problem.

Sido që të jetë, artikulli nuk sjell asgjë të re apo me interes publik për lexuesin. Në fakt, artikulli është një ndërhyrje në gjendjen shpirtërore, ndjenjat dhe mendimet private të një studenti, djali i të cilit rastësisht është një ministër i përfshirë në një skandal. I biri i tij nuk është zyrtar publik vetë dhe është e qartë që nuk ka impakt apo nuk është i lidhur me skandalin. Pra, pse duhet të përfundojë në faqet e gazetave në një moment kaq të vështirë? Cili është interesi publik në gjithë këtë? Për më tepër, a është marrë informacioni në një mënyrë korrekte? Facebook-u është një rrjet social, por a do të thotë kjo që të gjithë janë të lirë të marrin informacionin që gjendet atje dhe ta përhapin për qëllime të ndryshme nga ato që kanë pasur ata që e vunë informacionin aty?

Këto të gjitha janë pyetje që u lindin përdoruesve të Facebook apo atyre të rrjeteve të tjera të ngjashme, kur janë përfshirë me apo pa dëshirën e tyre. Megjithatë, ndërkohë që secili individ mund të bëjë zgjedhjet e tij në këtë aspekt, konsideratat etike të gazetarëve duhet të jenë më të lehta: ata nuk mund ta bëjnë publik informacionin e marrë në këtë mënyrë, me përjashtim të rasteve kur ka një interes të qartë publik. A është ky një rast i tillë? Kjo gazetë padyshim vendosi që është një rast i tillë, edhe pse, në fund të fundit, interesi nuk është tejet i qartë.

<sup>7</sup> “Viktor Pango: “Duke pritur Godot,” *Shekulli*, 11.03.2009, f.17.



Rasti i dytë i analizuar në lidhje me çështjet e privatësisë është ajo e një të riu që në një mënyrë kërkonte famën: një nga finalistët e “Big Brother Albania,” Bjordit. Vetë vendimi për të hyrë në një program të tillë, për shumë njerëz do të thotë që ti heq dorë nga çdo thërrime privatësie dhe se jeta jote tashmë është e hapur për publikun. Megjithatë, artikulli në fjalë<sup>8</sup> sërish është ndërtuar mbi informacionin e marrë nga një faqe e Facebook dhe jo nga burimet e marra nga transmetimet TV:



Artikulli ka foto nga faqja e Facebook, të cilat tregojnë motrën e Bjordit nga e ëma dhe Bjordin. Familja e tij ka pasur një histori të vështirë, si ato të familjeve të ndara nga përndjekja politike gjatë komunizmit. Për pasojë, e ëma ishte martuar sërish dhe Bjordit ka një motër, e cila nuk ishte përmendur në programin televiziv. Artikulli në gazetë supozon se e ëma duhet ta kishte ndarë këtë fakt me të gjithë publikun dhe jo ta mbante të fshehtë.

Për më tepër, artikulli thotë: “Motra e Bjordit quhet Skerda (emri i plotë dhe lidhjet familjare gjenden pranë redaksisë.) Ne kemi siguruar edhe një foto të Bjordit me të motrën.” Padyshim që ndihen nota krenarie për arritjen e gazetës në sigurimin dhe ekspozimin e një informacioni të tillë, duke pretenduar se ata kanë prova për atë që po thonë. Ndërkohë që askush nuk e vë në dyshim vërtetësinë e pretendimeve të gazetës, një pyetje më e rëndësishme në këtë aspekt do të ishte se cili është interesi për të kërkuar një informacion të tillë? Pse kjo është diçka që publiku duhet ta dijë patjetër? Dhe a është e pranueshme të futesh në faqet e të tjerëve për të siguruar një informacion të tillë?

Sërish, pyetjet dhe vendimet janë në dorë të redaksive dhe këto të fundit në përgjithësi e flijojnë privatësinë për nocionin që sipas tyre përbën informacion të dobishëm. Edhe pse këto praktika patjetër që mund të mbrohen në emër të lirisë së shprehjes, ato mund të vihen në diskutim në emër të interesit publik. Hapësira në gazetë dhe përpjekjet që disa gazetarë bëjnë për të “hetuar” një informacion të tillë mund të përdoren për tema të tjera, me rëndësi më të madhe sociale apo me një interes më të madh publik. Për më tepër, këta artikuj mund të jenë interesantë për publikun, po me përjashtim të vendosjes së disa standarteve informacioni që nuk përdoren nga gazeta që pretendojnë se janë serioze, ato gjithashtu edhe përlligjin dhe ndonjëherë edhe mitizojnë praktikën e marrjes së

<sup>8</sup> “Zbulohet motra sekrete e Bjordit,” Shekulli, 22.03.2009, f.16.

informacionit duke përdorur mënyra të ngjashme me ato të piratëve informatikë. Padyshim që këto janë praktika të debatueshme në media dhe ndoshta do të jenë pjesë e debatit edhe në vitet që do të vijnë.

## **Përfundimet**

Në përgjithësi, mund të thuhet se çështjet e privatësisë janë një temë delikate kur bëhet fjalë për monitorimin e pasqyrimet që u bëhen në mediat kryesore shqiptare. Praktikrat e diskutueshme etike janë të dukshme, edhe pse të thuash që këto praktika janë mbizotëruese do të ishte e tepruar. Interesi publik nuk është i përkufizuar qartë dhe as nuk ndiqet me besnikëri si parim, duke gjykuar nga përmbajtja e artikujve.

Ajo që duket se është më shqetësuese përse i përket aspektit etik të jetës private është prirja për të ndërhyrë në jetën private, sidomos në rastet e zisë. Pothuajse asnjë gazetë nuk tregon ndonjë delikatesë apo dhimbisuri të veçantë në këtë drejtim, duke bërë garë me njëra-tjetrën se kush do të intervistojë njerëzit në zi apo viktimat e para, edhe pse jo gjithmonë ka një interes të qartë publik. Në këto raste është e qartë që përparësia i jepet marrjes së informacionit që padyshim është interesant për publikun, pa reflektime të matura për impaktin që kjo ka te viktimat dhe pa identifikuar qartë që më parë një interes të fortë publik.

Duket se gazetatat nuk bëjnë ndonjë dallim të qartë midis njerëzve publikë dhe atyre të thjeshtë në lidhje me jetën private, edhe pse është e qartë që interesi për figurat publike është më i madh. Një prirje shqetësuese dhe që duhet ndjekur në të ardhmen padyshim do të jetë edhe mënyra se si media e përdor teknologjinë në drejtimin e ndërhyrjes në jetën private apo në marrjen e informacionit.